



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15278 Prot.

Lezhë, më 02.10. 2023

VENDIM

Nr. 39, Datë 28. 09. 2023

Për një ndryshim në Vendimin e KB nr.120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023” dhe përdorim të fondit të kontigjencës

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e një ndryshimi si më poshtë:

-Në pikën 1, të Vendimit Këshillit Bashkiak nr.120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023”, bëhet ky ndryshim, konkretisht në pikën 1/b “Plani i Shpenzimeve”:

- Pakësohet Fondi i Kontigjencës : Gr.00, Prog.04940, Kap.01, Art.609 në shumën 534,000 lekë, për mbulimin e shpenzimeve për 3 punonjësit e çerdhes së qytetit për periudhën shtator-nëntor.
- Shtohen shpenzimet në : Gr.00, Prog.10430, Kap.01, Art.600 në shumën 458,000 lekë dhe Art.601 në shumën 76,000 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**



Prot. 15228/1
Dt. 8.10.23.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KB

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 787/2 Prot.

Lezhë, më 05.10.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar" si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.39 datë 28.09.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për një ndryshim në vendimin e KB nr.120, datë 02.12.2022" Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe buxhetit të vitit 2023 "dhe përdorim të fondit të kontigjencës".

PREFEKTI

Gjergj PRENDI




